



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM
(ME NJË OPERATOR EKONOMIK) ME NEGOCIM

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit te furnizimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë; dhe

“BANANA-S.H” me pronar z. Skender Hasani, nga Istogu, Rr. “UÇK STREET NO. 51” , me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 810128141, xh llogaria 1506021001477927 R. F. ne vazhdim “FURNITORI”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për FURNIZIMET si më poshtë:

FURNIZIMI ME PAKO USHQIMORE PËR FAMILJE SKAMNORE

Nr. I prokurimit	633-20 - 1083-1-2-5/C324
Nr. I brendshëm	633 / 020/ 010/ 121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave si në vijim:

FURNIZIMI ME PAKO USHQIMORE PËR FAMILJET SKAMNORE

Autoriteti Kontraktues bënë Furnizimin vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative që Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të kryejnë furnizime të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKATËSISHT ME DATË **22.04.2020** DHE DO TE PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME **31.12.2020** NGA DATA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS.

1.5 Kontrata mund të shpëputet edhe para skadimit të afatit të paraparë në Nenin 1.4. të kësaj kontrate, po që se kontrata permbushet me çmimin e paraparë sipas dispozitave të Nenit 56.10 të Udhezuesit Operativ ku “citohet” se nese kontrata permbushet me çmim pa marre parasysh Kohën e zgjatjes dhe nenshkrimin original e njëjta shkeputet automatikisht.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e të gjitha **FURNIZIMEVE** do të jetë: **31.12. 2020** si afat I skadimit të afatit të kontratës.

2.2 Vendi ku do të dorëzohen artikujt do të jenë **INSTITUCIONET KOMUNALE TE ISTOGUT, respektivisht do të caktohet nga Drejtorati për Shërbime Publike.**

2.3. Obligimet e kontraktorit janë të gjitha furnizimet të përcaktuara në Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve të përgjithshme dhe të veqanta të kontratës.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Kryersi I furnizimeve duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të tyre. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi:

4.1 Kjo kontratë është e lidhur me çmime për njësi. Çmimet njësi të furnizimeve janë të paraqitura në ofertën financiare të kontraktorit pas **NEGOCIMIT** dhe kjo shumë është **25,00 €** dhe me shkronja: **/Njëzetepesëeuro/**

Vlera e parashikuar e kontratës për periudhën **deri me 31.12.2020** është: **50.000,00 Euro**. Dhe me shkronja: **/Pesëdhjetëmijëeuro/**

4.2 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do t'i nënshtrohen ndryshimeve për porosity e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim,

miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye




6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut:

Për Furnizuesin:

“BANANA-S.H” Shpk

Emri:	<i>Zizë Bujupaj</i>	Emri:	<i>Skender Hasani</i>
Pozita:	<i>Zyrtar përgjegjës i Prokurimit</i>	Pozita:	<i>D r e j t o r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>22.04/20</i>	Data:	<i>22-04-2020</i>
Vula:		Vula:	

Nr	Pershkrimi	Njësia	Sasia e perafert	Sasia	Çmimi per njesi
1	Miell (tup 400) 25 kg/1	Thasë	1600	1thes	11.5
2	Vaj ushqimor 1/1	lit	4000	1liter	1.01
3	Qumshhtë i pa sterilizuar 3.2 (tetrapakë) 1/1	lit	4000	1liter	0.88
4	Sheqer 1/1	kg	3200	1kg	0.65
5	Oriz 1/1	kg	1600	1kg	0.87
6	Pasta (makarona divella) 1/2 kg	copë	3200	1cope	0.64
7	Pasul 1/1	kg	1600	1kg	1.97
8	Krip e jodizur 1/1	kg	1600	1kg	0.26
9	Konzerva (argeta) 1/0.95 g	copë	4800	1cope	0.75
Emri i artikullit (pershkrimi) pako higjienike					
1	Detegjent për troba 3/1	kg	2400	1kg	2.76
2	Shampon për enë 1/1	lit	800	1liter	0.82
3	Shampon për duar 1/1	lit	800	1liter	0.87
4	Shampon për flokë 0.51	copë	800	1cope	0.98
5	Sapun i ngurt	copë	1600	1cope	0.36
6	Pastë për dhembë 1/50 ml	copë	1600	1cope	0.6
7	Dezinfectues per toaletë (domesdos) 1/0.75 l	copë	800	1cope	1.08
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT I CMIMEVE PER NJESI					€ 26.00

Liferimi i pakove ushqimore duhet te behet nga operatori ekonomik gjere tek familjet skamnore, varsisht nga kerkesat e njesise kerkuese. (Brenda komunes se Istogut)

10,50 (-1)

25 €

